
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR , PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik “ASI INVEST” sh.p.k**

NUIS M01927023H

Adresa: Tiranë, Rruga " Xhorxhi Martini", Ndertesa Nr. 17, Kati 3, Apartamenti 4, Hyrja 5.

Tipi i Kontratës: Shërbim.

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedure e hapur”, mbi kufirin e larte monetarë.

Numri i Procedurës: **REF- 49690-05-30-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shërbim lyerje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave për Spitalin Universitar të Traumës”** Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Fondi Limit: **20,827,524** (njëzete milion e tetëqind e njëzete e shtate mije e pesëqind e njëzete e katër) lek pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: **24** (njëzetë e katër) Muaj.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 02.06.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr.29 date 09.06.2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “2 N” sh.p.k.

NUIS L31615017L

Vlera: **18,907,500** (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Operatori Ekonomik “ASI INVEST” sh.p.k.

NUIS M01927023H

Vlera: **13,817,475** (trembedhjetemilion e teteqind e shtatembedhjetemije e katerqind e shtatedhjetë e pese) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Operatori Ekonomik “DAJTI PARK 2007” sh.p.k.

NUIS K11507003S

Vlera: **13,976,940** (trembedhjetemilion e nenteqind e shtatedhjetë e gjashtëmije e nentëqind e dyzetë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Operatori Ekonomik “MENI” sh.p.k.

NUIS J61909018W

Vlera: **13,937,185** (trembëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatëmijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k.

NUIS 810802422

Vlera: **15,665,650** (pesembedhjetë milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e pese mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “MENI” sh.p.k.

NUIS J61909018W

Për arsye se:

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 në të cilën është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.*”

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur në SPE dokumentacionin (skedarët) si më poshtë:

- **FATURA TVSH PUNE E NGJASHME, dhe KONTRATAT PUNE E NGJASHME**

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar **gjatë tre viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëre prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, konstaton se vetëm një nga faturat tatimore lëshuar për: “Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë”, më datë 20.07.2022 me vlerë 1,524,050 lekë, përmbush elementin kohe dhe është realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ndërsa faturat e tjera janë realizuar jashtë afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Sa më lartë, nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për kontratat e ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, vëren se nga përllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura nga ofertuesi rezultojnë në një vlerë më të vogël se 8,331,009.6 lekë pa t.v.sh që përben 40 % të vlerës së fondit të limit të kërkuar në DST) duke mos plotësuar kështu elementin vlerë të përcaktuar në DST.

Sa më lartë, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, vëren se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.1 pasi nga përllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura rezultojnë në një vlerë më të vogël se 8,331,009.6 lekë pa t.v.sh të kërkuar në DST.

2. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k.

NUIS 810802422

Për arsye se:

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 në të cilën është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat

tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur në SPE dokumentacionin (skedarin) si më poshtë:

- **PUNA E NGJASHME LEZHE-RSMH**

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar **gjatë tre viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëre prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, konstaton se vetëm një nga faturat tatimore lëshuar për: “*Bashkinë Korçë*”, më datë 09.06.2022 me vlerë 5,778,095 lekë, përmbush elementin kohe dhe është realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ndërsa faturat e tjera dhe kontrata janë realizuar jashtë afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Sa më lartë, nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për kontratat e ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, vëren se nga përlllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura nga ofertuesi rezultojnë në një vlerë më të vogël se 8,331,009.6 lekë pa t.v.sh që përben 40 % të vlerës së fondit të limit të kërkuar në DST) duke mos plotësuar kështu elementin vlerë të përcaktuar në DST.

Sa më lartë, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, vëren se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.1 pasi nga përlllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura rezultojnë në një vlerë më të vogël se 8,331,009.6 lekë pa t.v.sh të kërkuar në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. Operatori Ekonomik “ASI INVEST” sh.p.k.

NUIS M01927023H

Vlera: **13,817,475** (trembedhjetemilion e teteqind e shtatembedhjetemije e katerqind e shtatedhjte e pese) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.